



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 640 Akti

Nr. 669 Vendimi  
Tiranë, më 29.5.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Roland Ilia</b>	Kryesues
<b>Suela Zhegu</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, në datën 29.5.2023, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Matilda Fetau**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu në cilësinë e relatores, Roland Ilia kryesues dhe Genta Tafa (Bungo) anëtare. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.1.2021 u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues komisioneri Roland Ilia. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Willem Brouwer.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konkluduar se:
  - deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
  - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
  - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
  - nuk ka kryer deklarim të rremë;
  - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport të arsyetuar<sup>2</sup>, duke konkluduar mbi *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Matilda Fetau*.
7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>3</sup> mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 19.5.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Matilda Fetau dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.
10. Për një proces të rregullt ligjor, subjekti Matilda Fetau i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Znj. Matilda Fetau, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 25.5.2023. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me rezultatet e hetimit,

<sup>1</sup> Raport dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.4.2019.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i AKSIK-së, i deklasifikuar pjesërisht, me vendimin nr. \*\*\* , datë 26.4.2023, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Raporti nr.\*\*\* prot., datë 15.9.2021, i KLGJ-së.

deklaroi se është dakord me gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 26.5.2023.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 29.5.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Willem Brouwer.
14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Matilda Fetau ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror, i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror,

i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
  - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
  - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
  - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
  - ç. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
  - d. raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
  - dh. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
  - e. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
  - ë. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, të depozituara nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
22. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Matilda Fetau, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI**

23. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, si dhe mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
24. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga znj. Matilda Fetau në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, e dorëzuar në ILDKPKI në datën 29.1.2017 në zbatim të ligjit, ku subjekti ka deklaruar:
25. **Tokë bujqësore (arë)**<sup>4</sup> me sip. 10.310 m<sup>2</sup>, pasuri në bashkëpronësi të anëtarëve të familjes bujqësore, e ndodhur në fshatin Q, Skrapar. Pjesa takuese: 25 %.

---

<sup>4</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën aktin nr. \*\*, datë 22.5.1992, të marrjes së tokës në pronësi, në emër të shtetasit S.F (babai si kryefamiljar) për tokën me sip. 10.310 m<sup>2</sup> në rrethin Skrapar, fshati Q.

25.1. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar aktin nr. \*\*, datë 22.5.1992, të marrjes së tokës në pronësi, për pasurinë në bashkëpronësi me shtetasit S.F, M.F dhe S.F (anëtarë të familjes bujqësore).

25.2 Nga verifikimi i kryer përmes sistemit multifunksional të ASHK-së<sup>5</sup>, konfirmohet se në regjistrin elektronik të pasurive nuk ka të regjistruara pasuri të paluajtshme, në pronësi të subjektit Matilda Fetau<sup>6</sup>, si dhe babait të saj S.F.

Gjithashtu, referuar përgjigjes së ZVRPP-së Skrapar, me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 18.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2017, të administruara në dosjen e ILDKPKI-së<sup>7</sup>, nuk ka rezultuar pasuri e paluajtshme e regjistruar në emër të subjektit Matilda Fetau. Midis akteve, ndodhet edhe *email*-i i ZVRPP-së Skrapar, i datës 25.4.2019, i cili konfirmon se nga kontrolli i kryer në mënyrë manuale shtetasi S.F nuk ka kryer asnjë marrëdhënie juridike me AMTP-në nr. \*\*, datë 22.5.1992, deri në datën 31.1.2017 dhe në vazhdim.

25.3 Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri edhe në DPV-në e para fillimit të detyrës së vitit 2014, si anëtare e familjes bujqësore me pjesë takuese 25 %.

25.4 Referuar AMTP-së nr. \*\* akti, datë 22.5.1992, rezulton se babai i subjektit S.F ka përfituar me ligjin nr. 7501 tokë bujqësore në fshatin Q, Skrapar dhe referuar certifikatës<sup>8</sup> së përbërjes familjare të datës 1.8.1991, subjekti figuron anëtare e familjes bujqësore dhe zotëron 25% pjesë nga kjo pasuri.

### **Konstatim i Komisionit**

25.5 Nga hetimi i kryer për këtë pasuri, subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në bashkëpronësi, të përfituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991.

## **26. Llogari page<sup>9</sup> në “Raiffeisen Bank”, e çelur më 5.10.2012, me gjendje 27.159 lekë në datën e deklarimit 29.1.2017.**

26.1 Si burim krijimi subjekti ka deklaruar pagat nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

26.2 “Raiffeisen Bank<sup>10</sup>” ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të subjektit Matilda Fetau, e çelur në vitin 2012, ku nga verifikimi i llogarisë bankare evidentohen pagat e kredituara në llogarinë e subjektit nga Shkolla e Magjistraturës për periudhën 2012 – 2014, si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e, më tej Elbasan, për periudhën nga viti 2014 e në vijim, ku gjendja e llogarisë në datën 24.1.2017 është 27.159 lekë.

---

<sup>5</sup> Vërtetimi i gjeneruar elektronikisht nga sistemi i ASHK-së, datë 28.4.2023, për aplikimet nr. \*\*\*, datë 17.3.2023 dhe nr. \*\*\*, datë 17.3.2023.

<sup>6</sup> Përveç një pasurie apartament me nr. \*\*\*, i blerë në dhjetor të vitit 2022, i cili do të trajtohet në vijim të këtij vendimi.

<sup>7</sup> Të administruara pranë ILDKPKI-së me nr. \*\*\*a prot., datë 19. 9.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2018.

<sup>8</sup> Dokument i depozituar nga subjekti me *email* në datën 26.4.2023. Sipas certifikatës familjare, mbiemri i familjes së subjektit është Feta dhe jo Fetahu, ku për këtë fakt subjekti ka depozituar vërtetimin administrativ nr. \*\* prot., datë 20.4.2018, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Skrapar, vërtetim i cili konfirmon se shtetasi S.F është i njëjti person me shtetasin S.F.

<sup>9</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie në emër të subjektit Matilda Fetau nga “Raiffeisen Bank” për periudhën 31.10.2012 – 23.1.2017, ku gjendja e llogarisë është 27.159,78 lekë.

<sup>10</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

## **Konstatim i Komisionit**

26.3 Nga hetimi i kryer, lidhur me llogarinë bankare, subjekti ka kryer deklaram të saktë, pasi deklaramet përputhen me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

### **27. Automjet<sup>11</sup> tip “Toyota”, i blerë në vitin 2016, në vlerën 2.100 euro.**

27.1 Si burim për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar kursimet e krijuara nga paga e punës si gjyqtare dhe të tërhequra nga llogaria e pagës në datën 2.8.2016.

27.2 DPSHTRR-ja<sup>12</sup> ka konfirmuar automjetin me targa AA \*\*\* FK të regjistruar në pronësi të znj. Matilda Fetau. Nga verifikimi i dosjes së automjetit ka rezultuar se znj. Matilda Fetau ka lidhur me shtetasin M.LI kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 2.8.2016, për blerjen e automjetit tip “T.Y”, me vit prodhimi 2001, kundrejt çmimit 2.100 euro, i cili është likuiduar tërësisht nga blerësja.

27.3 Komisioni verifikoi lidhur me ndonjë trajtim preferencial në çmimin e blerjes së automjetit, ku nga aktet në dosje ka rezultuar se dy muaj më parë, në datën 14.6.2016, shitësi M.LI e ka blerë këtë automjet nga shtetasi M.M, me çmimin 2.400 euro. Ndërsa shtetasi M.M ka kryer zhdoganimin e këtij mjeti në datën 20.12.2013, ku vlera e mjetit është 100.000 lekë + zhdoganimi 24.195 lekë.

✓ Nuk evidentohet ndonjë trajtim preferencial lidhur me çmimin e blerjes së automjetit.

27.4 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësin e automjetit dhe nga përgjigjja e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Elbasan<sup>13</sup>, ku subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtares, nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtij shtetasi.

✓ Nga verifikimi i kryer nuk rezultoi ndonjë e dhënë, ku subjekti të gjendet në një nga rastet e parashikuara në ligj.

## **Burimi i krijimit**

27.5 Në deklaramtën *Vetting* dhe DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e automjetit kursime nga paga si gjyqtare dhe të tërhequra në datën 2.8.2016 nga llogaria e pagës.

27.6 Nga verifikimi i të dhënave bankare të subjektit pranë “Raiffeisen Bank<sup>14</sup>”, evidentohet tërheqja e shumës 304.000 lekë në të njëjtën ditë kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes, datë 2.8.2016.

---

<sup>11</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramtës: (1) kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 2.8.2016, me palë shitëse z. M. LI dhe palë blerëse znj. Matilda Fetau, të automjetit tip “Toyota Yaris”, me numër shasie JTDKV\*\*\*, me targë AA \*\*\* FK, vlerë 2.100 euro; (2) mandat nga “Raiffeisen Bank”, datë 2.8.2016, ku subjekti Matilda Fetau ka tërhequr shumën 304.000 lekë; (3) certifikatë nr. \*\*\*, datë 3.8.2016, të pronësisë së mjetit rrugor dhe leje qarkullimi nr. TRDB\*\*\*, datë 3.8.2016, për automjetin “Toyota Yaris”, me targë AA \*\*\* FK, në pronësi të subjektit Matilda Fetau; (4) nxjerrje llogarie në emër të subjektit Matilda Fetau nga “Raiffeisen Bank” për periudhën 31.10.2012 – 23.1.2017. Në datën 2.8.2016, llogaria është debituar në shumën 304.000 lekë.

<sup>12</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2021.

<sup>13</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>14</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

## **Analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e automjetit**

27.7 Komisioni analizoi mundësitë financiare të subjektit për blerjen e automjetit në datën 2.8.2016, në shumën 2.100 euro ose 304.000 lekë.

27.8 Për kryerjen e analizës u morën në konsideratë të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e subjektit dhe bashkëshortit për periudhën janar 2014 – 2.8.2016 për subjektin dhe për periudhën korrik 2014 – 2.8.2016 për bashkëshortin, referuar deklaramit të fillimit të bashkëjetesës së të dyve.

27.9 Të ardhurat e subjektit nga pagat janë përlllogaritur neto sipas dokumentacionit të administruar në dosjen hetimore të subjektit nga:

- paga dhe shpërblime, bazuar në pagat e kredituara në bankë, si dhe vërtetimet e lëshuara nga institucioni përkatës për periudhën 2014 – gusht 2016;
- të ardhurat e bashkëshortit janë përlllogaritur bazuar në vërtetimet për pagat dhe shpërblimet në vite për periudhën korrik 2014 – gusht 2016;
- shpenzimet e jetesës janë llogaritur bazuar në shkresën nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, të ILDKPKI-së;
- shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit, bazuar në të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, konkretisht lëvizjet hyrje - dalje nëpërmjet të dhënave të sistemit TIMS për subjektin e rivlerësimit dhe familjarëve, si dhe u krahasuan/plotësuan me deklaramit e subjektit;
- shpenzimet për qiranë janë përlllogaritur referuar dokumentacionit dhe deklaramit të subjektit.

## **Analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për blerjen e automjetit**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2014 – 2.8.2016</b>
Të ardhura të subjektit	2 236 357
Të ardhura të bashkëshortit	876 944
<b>Të ardhura total</b>	<b>3 113 301</b>
Shpenzime jetese	1 071 156
Shpenzime udhëtimi	162 169
Shpenzime qiraje	469 667
<b>Total shpenzime</b>	<b>1 702 992</b>
Ndryshim i likuiditeteve	- 39 602
Pasuri automjet	304 000
<b>Rezultati financiar</b>	<b>1 066 707</b>

## **Konstatime të Komisionit**

27.10 Subjekti ka kryer deklaramit të saktë në deklaramitën *Vetting*, në përputhje me ligjin nr. 84/2016. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit me burime të ligjshme.

## **DETYRIMET FINANCIARE**



28. Në deklaratën *Vetting*, tek rubrika e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar si vijon:

**29. Kredi *overdraft***<sup>15</sup> pranë “Raiffeisen Bank” me kontratën e kredisë datë 4.9.2015, me limit *overdraft*-i 240.000 lekë. Shuma e detyrimit financiar është 0 (zero) lekë, sepse nuk është tërhequr *overdraft*-i.

29.1 Nga të dhënat bankare të dërguara nga “Raiffeisen Bank<sup>16</sup>” evidentohen llogaritë e kredive të subjektit Matilda Fetau pranë kësaj banke.

29.2 Subjekti ka depozituar kontratën e kredisë *overdraft*, të lidhur në datën 4.9.2015 me “Raiffeisen Bank”, për shumën e kredisë 240.000 lekë. Në kontratë përcaktohet se kredia jepet për të gjithë periudhën gjatë së cilës kredimarrësi është i punësuar me kohë të plotë pranë shoqërisë, e cila ka lidhur marrëveshje për pagesën e pagave të punonjësve të saj.

Nga verifikimi i pasqyrës së llogarisë së subjektit, evidentohet gjendja e llogarisë së *overdraft*-it me limit në vlerën 240.000 lekë.

29.3 Nga hetimi i kryer, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar nga banka.

**30. Kredi bankare**<sup>17</sup>, marrë në “Raiffeisen Bank” me kontratën e datës 14.9.2016, në shumën 59.930 lekë, me qëllim blerje pajisjesh elektroshtëpiake. Detyrimi i mbetur është deklaruar në vlerën 45.625 lekë.

30.1 “Raiffeisen Bank<sup>18</sup>” ka konfirmuar kredinë në emër të subjektit Matilda Fetau në shumën 59.930 lekë, e lëvruar në datën 23.9.2016 dhe mbyllur më 23.9.2017. Bashkëlidhur shkresës ndodhen dokumentet e kredisë ku, ndër të tjera, evidentohet konfirmimi për miratimin e kredisë në shumën 56.930 lekë<sup>19</sup> me afat 12 muaj, me qëllim blerje lavatrice, aksesorësh dhe hekur rrobash.

30.2 Nga hetimi i kryer, përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin bankar.

**31. Subjekti ka deklaruar cilësinë e dorëzanisë**<sup>20</sup> në kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me BKT-në, në shumën e kredisë 5.242.800 lekë, ku detyrimi i mbetur është në vlerën 4.892.085 lekë.

---

<sup>15</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratë kredie me kufi (*overdraft*) në shumën 240.000 lekë, datë 4.9.2015, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të kredimarrësit Matilda Fetau.

<sup>16</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

<sup>17</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) aplikimin datë 14.9.2016 nga subjekti Matilda Fetau në “Raiffeisen Bank”, për kredi në shumën 59.930 lekë, plan paraprak amortizimi kredie, datë 20.9.2016; (2) vërtetim mbi produktet bankare të znj. Matilda Fetau në “Raiffeisen Bank”, datë 27.1.2017, ku gjendja e detyrimit është në shumën 45.625 lekë.

<sup>18</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

<sup>19</sup> Duket se ka një gabim material, pasi subjekti e ka deklaruar vlerën e kredisë 59.930 lekë.

<sup>20</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë kredie bankare nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me BKT-në, për kredi në shumën 5.242.800 lekë, me qëllim blerjen e apartamentit nga shtetasit S.F dhe S.F, dorëzanës Matilda Fetau etj; (2) vërtetim nga BKT-ja, nr. prot. extra, datë 23.1.2017, mbi situacionin e kredisë, nëpërmjet të cilit vërtetohet se Matilda Fetau është dorëzënë në kredinë e përfutur nga S.F në datën 25.11.2013, në shumën 5.242.800 lekë. Gjendja e mbetur e kredisë në datën 23.1.2017 është 4.892.085 lekë. Shuma e shlyer e kësaj kredie deri në datën 23.1.2017 është 350.714 lekë.

31.1 Informacioni i ardhur nga BKT-ja<sup>21</sup> konfirmon se kredia bankare është disbursuar në llogarinë e babait të subjektit S. F, në datën 4.11.2013.

Nga praktika e kredisë ka rezultuar se shtetasit S.F dhe S.F (babai dhe motra e subjektit) kanë nënshkruar kontratën e kredisë në datën 19.10.2013, për marrjen e kredisë në shumën 5.242.800 lekë, me afat 360 muaj, me qëllim blerjen e një apartamenti. Subjekti e ka nënshkruar këtë kontratë në cilësinë e dorëzanesës.

31.2 Në deklarinimet<sup>22</sup> periodike vjetore nga viti 2014 dhe në vijim, tek rubrika e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar cilësinë e dorëzanesë në këtë kredi.

31.3 Komisioni i ka kërkuar<sup>23</sup> subjektit të deklarojë nëse ka kontribute në likuidimin e kësteve të kredisë, gjë për të cilën subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar<sup>24</sup> se që prej datës 26.7.2014 ka nisur bashkëjetesën me bashkëshortin, në banesën e marrë me qira me kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 24.11.2014 (noter D.H)<sup>25</sup>. Subjekti ka shpjeguar se është martuar në muajin korrik 2014, ndërsa lidhja e martesës ligjore është kryer në nëntor të vitit 2014.

Subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë kontribut për pagimin e kësteve të kredisë së babait, sepse babai dhe nëna e saj kanë të ardhura dhe kanë mundësi ta paguajnë vetë kredinë. Subjekti ka saktësuar se pas martesës është shkëputur tërësisht nga ekonomia e familjes së babait.

31.4 Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka depozituar kopje të kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 13.5.2013, për apartamentin e blerë nga babai i saj në Linzë, Tiranë, në çmimin 7.100.000 lekë, ku sipas kontratës së shitjes shuma prej 1.455.200 lekësh është likuiduar nga i ati S.F, ndërsa diferenca prej 5.644.800 lekësh do të likuidohej me kredinë bankare që do të çelej në favor të tij. Subjekti ka depozituar dokumentacion<sup>26</sup>

<sup>21</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.8.2021.

<sup>22</sup> 1. Në DPV-në e vitit 2014, para fillimit të detyrës (dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 27.11.2014): “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të pashlyer në shumën 5.139.583 lekë”;

2. Në DPV-në e vitit 2014: “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të shlyer 27.845 lekë dhe detyrim të mbetur të pashlyer në shumën 5.111.737 lekë”;

3. Në DPV-në e vitit 2015: “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të shlyer 94.918 lekë dhe detyrim të mbetur të pashlyer në shumën 5.016.819 lekë”;

4. Në DPV-në e vitit 2016: “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të shlyer 266.970 lekë dhe detyrim të mbetur të pashlyer në shumën 4.914.085 lekë”;

5. Në DPV-në e vitit 2017, subjekti ka deklaruar: “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të shlyer 266.970 lekë dhe detyrim të mbetur të pashlyer në shumën 4.781.721 lekë”.

6. Në DPV-në e vitit 2018, subjekti ka deklaruar: “dorëzanesë sipas kontratës së kredisë nr. \*\*\*, datë 19.10.2013, me detyrim të shlyer 266.970 lekë dhe detyrim të mbetur të pashlyer në shumën 4.659.267 lekë”.

<sup>23</sup> Përmes pyetësorit datë 19.4.2023.

<sup>24</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 26.4.2023.

<sup>25</sup> Kjo marrëdhënie qiraje do të trajtohet në vijim të këtij raporti.

<sup>26</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti, me *email* të datës 26.4.2023 dhe dorëzuar fizikisht pranë Komisionit me nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2023, i njësuar me origjinalin nga noteri me nr. \*\*\*, datë 28.4.2023:

- Vërtetim nr. \*\*\*prot., datë 1.4.2010, i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat nga punësimi i shtetasit M.F pranë Zyrës Vendore të Punësimit Skrapar për periudhën 30.6.1994 – 30.6.1995, tek firma “\*\*\*\*” për periudhën 1.8.1996 – 1.8.1997; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat e z. M.F pranë Zyrës Vendore të Punësimit Skrapar për periudhën 1.7.2001 – 16.1.2002, firma “\*\*\*\*” Skrapar; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat e z. M.F nga punëdhënësi komuna Ç, Skrapar, për periudhën 1.1.2002 – 31.12.2002; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat nga punësimi i z. M.F nga punëdhënësi komuna P, Skrapar, për periudhën 18.6.2003 – 18.6.2004; vërtetime

mbi të ardhurat e saj dhe të familjarëve, të cilat sipas deklarimeve të subjektit kanë shërbyer gjithashtu si burim për blerjen e apartamentit.

### **Konstatime të Komisionit**

31.5 Nga hetimi i kryer, nisur nga faktet e dala gjatë hetimit, ka rezultuar se:

- Apartamenti është blerë nga babai në datën 13.5.2013, kryesisht me kredi bankare, vit kur subjekti ka qenë studente në Shkollën e Magjistraturës, para emërimit të saj në detyrën e gjyqtares (qershor 2016).
- Prindërit nuk kanë banesë tjetër, pasi kanë jetuar në banesë me qira.
- Subjekti në vitin 2014 ka deklaruar bashkëjetesën duke ndryshuar vendbanimin.

**31.6 Nisur nga faktet e mësipërme, duket se subjekti nuk është në kushtet e parashikuara në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, Komisioni nuk e ka analizuar më tej këtë pasuri.**

**32. Apartament<sup>27</sup> me qira**, sipas kontratës së qirasë datë 23.1.2017, me afat 1-vjeçar dhe qira mujore 20.000 lekë, veç tatimit mbi të ardhurat.

32.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka depozituar kopje të kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, të nënshkruar midis saj në cilësinë e qiramarrëses dhe shtetasve L.T e E.Z, në cilësinë e qiradhënësve.

Përmes kësaj kontrate, subjekti Matilda Fetau ka marrë me qira një apartament të ndodhur në Linzë, Tiranë, me qira mujore 20.000 lekë. Afati i dhënies me qira është përcaktuar 1 vit, ku në kontratë palët deklarojnë se qiraja ka filluar në datën 1.10.2016 dhe vazhdon deri më 30.9.2017, me të drejtë rinovimi në rast mirëkuptimi midis palëve. Sipas kontratës, pala qiramarrëse merr përsipër të paguajë tatimin mbi të ardhurat prej

---

për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat e z. M.F nga punëdhënësi Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar për periudhën 1.4.2004 – 30.4.2010; tabelë (me nr. prot. dhe datë bosh), e lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Berat, e cila konfirmon kontributet e derdhura për periudhën prill 2004 – mars 2009 dhe firma “\*\*\*\*” Skrapar për periudhën prill 1996 – korrik 1996; lista e kontributeve, e printuar në datën 23.4.2023 nga ISSH-ja për z. M.F, nga viti 2012 – 2023; nxjerrje llogarie e z. M.F e lëshuar nga “Raiffeisen Bank” në datën 24.4.2023, për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2017 dhe periudhën 1.1.2018 – 24. 4.2023;

- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto mbi të ardhurat nga punësimi të babait të subjektit S.F pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Berat, për periudhat 22.8.1992 – 31.8.1998, 1.10.2000 – 31.12.2001 dhe 1.9.2003 – 30.4.2005; vërtetim për bazën e vlerësuar, i lëshuar elektronikisht nga ISSH-ja në datën 24.4.2023, i cili konfirmon të ardhurat e pagës së z. S.F pranë Drejtorisë së Policisë, nga viti 2012 deri aktualisht; vërtetim nr. S-\*\*\* prot., datë 24.4.2023, i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë; vërtetim nr. S-\*\*\* prot., datë 24.4.2023, i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë; vërtetim nr. S-\*\*\* prot., datë 24.4.2023, i lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë;
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2018, i Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë, e cila konfirmon pagesat e pensionit të kryera për znj. D.L për periudhën 1.1.2012 – 30.4.2018; mandate “tërheqje parash” të lëshuara nga Western Union, me marrës z. M.F dhe dërgues R.L, në datat 19.11.2013, 15.6.2013, 9.9.2013 dhe 18.7.2013;
- Lista e kontributeve e lëshuar nga ISSH-ja për znj. S.F nga viti 2012 – 2023; të dhëna mbi transaksionet bankare (e pjesëzuar nga f. 42 – 47) të znj. S.F pranë “Intesa Sanpaolo Bank”;
- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2016, i Shkollës së Magjistraturës, i cili konfirmon se znj. Matilda Fetau është paguar me bursë gjatë periudhës 2012 – 2014.

<sup>27</sup> Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, me palë qiradhënëse L.T dhe E.Z dhe qiramarrëse subjektin Matilda Fetau.

15% (tatim që me ligj i takon palës qiradhënëse), tatim i cili do të paguhet më vete, përjashtuar çmimin e qirasë.

32.2 Në pyetësoin standard, subjekti ka deklaruar se nga data 1.10.2016 jeton së bashku me bashkëshortin dhe fëmijën e tyre, në banesën e marrë me qira, të ndodhur në Linzë, rruga “M.A” (ose rruga “Th.F”), pallati B, Fresku, Tiranë, me qira mujore 20.000 lekë. Sipas subjektit, ky apartament fillimisht ka qenë në bashkëpronësi të shtetaseve L.T dhe E.Z (nënë e bijë) dhe, më pas, kjo banesë është vetëm në pronësi të shtetases E.Z.

Subjekti ka depozituar kopje të kontratës së qirasë<sup>28</sup>, datë 23.1.2017, si dhe një deklaratë noteriale<sup>29</sup>, datë 17.2.2020, të shtetases E.Z, e cila, ndër të tjera, deklaroi dhënien me qira të këtij apartamenti tek Matilda Fetau nga data 1.10.2016 deri aktualisht, ku apartamenti është i mobiluar në mënyrë modeste nga qiradhënësjja, ndërsa në pronësi të subjektit Matilda Fetau janë vetëm televizori dhe lavatriçja.

32.3 Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me qiradhënëset e apartamentit, znj. L.T dhe znj. E.Z. Nga përgjigjja e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Elbasan<sup>30</sup>, ku subjekti ka ushtruar detyrën e gjyqtares, nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtyre shtetaseve.

### **Konstatime të Komisionit**

32.4 Nga hetimi i kryer lidhur me apartamentin me qira duket se deklarimi i subjektit përputhet me aktet e administruara në dosje.

32.5 Nuk u evidentua ndonjë situatë konflikt interesi midis subjektit dhe qiradhënëseve.

### **DEKLARIMI I PASURIVE TË BASHKËSHORTIT**

**33. Llogari page<sup>31</sup> në “Raiffeisen Bank”, çelur në datën 12.11.2014, me gjendje -71.382 lekë, në datën 29.1.2017.**

33.1 Si burim krijimi është deklaruar paga nga Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes.

33.2 “Raiffeisen Bank”<sup>32</sup> ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të shtetasit P. M me gjendje -50.111 lekë (minus) dhe *overdraft* në shumën 179.000 lekë. Nga verifikimi i të dhënave bankare të bashkëshortit të subjektit pranë “Raiffeisen Bank”, evidentohen kreditime të pagës nga dhjetor 2014 dhe në vijim, ku gjendja e llogarisë në datën 30.1.2017 paraqitet në vlerën – 71.382 lekë, e cila përputhet me deklarin e kryer në deklaratën *Vetting*.

<sup>28</sup> Kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 23.1.2017 (noter D.H).

<sup>29</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 17.2.2020 (noter D.H).

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>31</sup> Bashkëlidhur deklaratës, subjekti ka bashkëlidhur: nxjerrje llogarie në emër të shtetasit P.M nga “Raiffesen Bank”, lëshuar në datën 24.1.2017, për periudhën 24.1.2016 – 24.1.2017, nga e cila rezulton se llogaria ka gjendje debitore -71.382,42 lekë.

<sup>32</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

33.3 Nga hetimi i kryer, deklarimi i bashkëshortit përputhet me dokumentacionin bankar.

### **DETYRIMET FINANCIARE<sup>33</sup>**

34. Tek rubrika e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, bashkëshorti ka deklaruar:

**35. Kredi *overdraft*** tek “Raiffeisen Bank” me kontratën datë 14.7.2015, për limitin e *overdraft*-it 120.000 lekë. Shuma e detyrimit financiar është deklaruar në vlerën 71.382 lekë.

35.1 “Raiffeisen Bank<sup>34</sup>” ka konfirmuar llogarinë *overdraft* në emër të shtetasit P. M në shumën 179.000 lekë. Bashkëlidhur shkresës ndodhet *statement*-i me lëvizjet e llogarive, si dhe tabela me të dhënat përkatëse, ku evidentohet gjendja me minus e llogarisë *overdraft* në shumën 71.382 lekë, në datën 24.1.2017.

35.2 Nga verifikimi i kryer, deklarimi i bashkëshortit të subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

### **VERIFIKIME TË TJERA**

**36. Komisioni hetoi në lidhje me adresat e banimit të subjektit**, të deklaruara nga viti 2014 (periudhë kur subjekti ka qenë duke kryer stazhin profesional), adresa të cilat iu referohen banesave të marra me qira nga subjekti. Konkretisht, nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore të subjektit evidentohet se:

36.1 Në DPV-në e vitit 2014 (para fillimit të detyrës)<sup>35</sup>, subjekti ka deklaruar si adresë vendqëndrimi: Rruga e Dajtit, kompleksi \*\*\*, Q, Tiranë.

Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se nga data 26.7.2014 në datën 30.9.2015 ka jetuar në një banesë me qira mujore 18,000 lekë, në pronësi të shtetasit E.M, në adresën: Rruga e Dajtit, kompleksi \*\*\*, Fresku, Tiranë. Subjekti ka deklaruar se kontrata është zgjidhur përpara afatit me mirëkuptimin e palëve, si dhe ka depozituar kopje të kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 24.11.2014, të lidhur me qiradhënësin E.M, ku përcaktohet se afati i qirasë është 2 vjet.

Gjatë hetimit, subjekti ka shpjeguar<sup>36</sup> se është martuar me bashkëshortin P.M në muajin korrik 2014 dhe që prej datës 26.7.2014 ka nisur bashkëjetesën me bashkëshortin në këtë banesë të marrë me qira.

Komisioni verifikoi lidhur me origjinën e fitimit të kësaj pasurie nga qiradhënësi E. M, ku nga verifikimi i kryer ka rezultuar se qiradhënësi ka porositur ndërtimin e këtij apartamenti pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me kontratën e sipërmarrjes datë 30.8.2012, periudhë para emërimit në detyrë të subjektit (qershor 2016).

---

<sup>33</sup> Bashkëlidhur deklaratës: (1) kontratë kredie me kufi (*overdraft*) në shumën 120.000 lekë, datë 14.7.2015, nga “Raiffeisen Bank”, në emër të kredimarrësit P.M për kredinë; (2) nxjerrje llogarie në emër të z. P.M nga “Raiffeisen Bank”, lëshuar më 24.1.2017, për periudhën 24.1.2016 – 24.1.2017, nga e cila rezulton se llogaria ka gjendje debitore -71.382,42 lekë.

<sup>34</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2021.

<sup>35</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së në datën 27.11.2014.

<sup>36</sup> Shpjegimet e subjektit të depozituara në datën 26.4.2023.

Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me qiradhënësin, ku nga përgjigjja e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Elbasan<sup>37</sup> nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtyre shtetasve.

36.2 Në DPV-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi: Rruga e Dajtit, Q, Tiranë. Në pyetësoin standard, subjekti ka deklaruar se nga 1.10.2015 – 30.9.2016 ka jetuar së bashku me bashkëshortin në adresën: Rruga e Dajtit, pallati \*\*\*, Fresku, Tiranë. Sipas subjektit, marrëveshja e qirasë ka qenë verbale me familjen e z. B.G dhe çmimi i qirasë mujore ka qenë 22.000 lekë, e cila i është paguar *cash* shtetasës N.G, bashkëshorte e B.

Komisioni hetoi lidhur me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit të rivlerësimit me qiradhënësit B dhe N.G dhe nga përgjigjja e ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Elbasan<sup>38</sup> nuk kanë rezultuar procedime penale të regjistruara në emër të këtyre shtetasve.

36.3 Në DPV-në e vitit 2016 dhe deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi rruga “Th.F”, Linzë, Tiranë, adresë e cila i përket apartamentit me qira të marrë nga subjekti tek shtetasët L.T dhe E.Z, me kontratën e qirasë datë 23.1.2017, e cila gjendet e trajtuar më sipër (pika 32 e këtij vendimi).

### **Konstatime të Komisionit**

36.4 Nga hetimi i kryer nuk u evidentua ndonjë situatë konflikti interesi apo problematikë ndërmjet subjektit me qiradhënësit e këtyre banesave.

## **37. Komisioni verifikoi lidhur me apartamentin në emër të subjektit dhe bashkëshortit.**

37.1 Nga verifikimi i kryer përmes sistemit multifunksional të ASHK-së<sup>39</sup>, në regjistrin elektronik të pasurive ka rezultuar një pasuri e paluajtshme “apartament” me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*, f. \*\*\*, e regjistruar në emër të subjektit Matilda Fetau dhe bashkëshortit P.M.

37.2 Komisioni i ka kërkuar<sup>40</sup> subjektit të depozitojë dokumentacion ligjor mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, si dhe të deklarojë burimet e krijimit.

Subjekti ka shpjeguar<sup>41</sup> se ky apartament është blerë me kontratën e shitjes me rezervë kalim pronësie nr. \*\*\*, datë 13.12.2022, dhe si burim krijimi kanë shërbyer:

i) Kredia bankare e marrë pranë “Raiffeisen Bank” sh.a. në shumën 7.420.500 lekë, me kontratën e kredisë dhe hipotekës me nr. \*\*\*, datë 14.1.2023.

<sup>37</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>38</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>39</sup> Vërtetime të nënshkuara elektronikisht nga sistemi i ASHK-së në datën 28.4.2023, për aplikimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2023 dhe aplikimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2023.

<sup>40</sup> Përmes pyetësorit me *email*-in e datës 19.4.2023.

<sup>41</sup> Shpjegimet e subjektit me *email*-in e datës 26.4.2023.

ii) Kursime në shumën 11.500 euro, duke saktësuar se në datën 5.12.2022 gjendja e llogarisë së pagës ka qenë 2.403.455 lekë. Po ashtu, ka pasur gjendje *cash* 100.000 lekë dhe në llogarinë bankare në euro ka pasur 725 euro, që janë përdorur për plotësimin e këstit të parë të apartamentit në shumën 11.500 euro. Subjekti ka shpjeguar se të gjitha provohen me lëvizjet e shumave që janë kryer nëpërmjet llogarisë bankare në emrin e saj.

Subjekti ka depozituar<sup>42</sup> si dokumentacion provues kontratën e shitjes me rezervë kalim pronësie, datë 13.12.2022, kontratën e kredisë bankare dhe hipotekës datë 14.1.2023, si dhe mandatin për pagesën e shumës 11.500 euro.

37.3 Komisioni ka administruar kopje të dokumentacionit tekniko-ligjor të kësaj pasurie nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Rurale<sup>43</sup>, ku ka rezultuar se subjekti Matilda Fetau dhe bashkëshorti i saj kanë nënshkruar me shitësit U.B dhe E.B një kontratë shitjeje me rezervë kalim pronësie datë 13.12.2022, për blerjen e një apartamenti me sip. 117.96 m<sup>2</sup> në Linzë, Tiranë, me çmim 75.000 euro.

Në kontratë, palët kanë përcaktuar se kësti i parë 11.500 euro do të paguhej nga pala blerëse pas nënshkrimit të kontratës dhe do të kalojë në llogarinë e noteres O.D pranë “Raiffeisen Bank”, ndërsa diferenca e mbetur prej 63.500 euro do të paguhej me marrjen e një kredie pranë “Raiffeisen Bank”, për një afat 2-mujor.

Në datën 14.1.2023, subjekti Matilda Fetau dhe bashkëshorti P.M kanë nënshkruar me “Raiffeisen Bank” kontratën e kredisë bankare dhe hipotekës për shumën e kredisë 7.420.500 lekë, me qëllim blerje shtëpie. Në kontratën e kredisë përcaktohet se shuma e aprovuar e kredisë do të transferohet në llogarinë e noteres O.D për pagesën e mbetur të çmimit të apartamentit, sipas kontratës së shitjes me rezervë, datë 13.12.2022.

### **Konstatime të Komisionit**

37.4 Nga verifikimi i kryer nuk evidentohen problematika lidhur me apartamentin e blerë nga subjekti dhe bashkëshorti.

37.5 Nisur nga fakti që kjo pasuri është blerë në vitin 2022, vite jashtë periudhës së rivlerësimit, Komisioni nuk ka detyrimin ligjor ta analizojë më tej këtë pasuri.

### **38. Komisioni verifikoi të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS**

38.1 Nga të dhënat e gjeneruara nga sistemi TIMS<sup>44</sup> ka rezultuar se subjekti ka udhëtuar jashtë shtetit kryesisht nga Komisariati i Policisë Rinas. Në pyetësorin standard, subjekti ka dhënë shpjegime të detajuara mbi udhëtimet e kryera dhe personat me të cilët ka udhëtuar, më së shumti me bashkëshortin e saj.

38.2 Nga hetimi i kryer duket se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e përcjellë nga sistemi TIMS.

38.3 Shpenzimet për udhëtimet gjatë periudhës 2014 – 2016 janë reflektuar në analizën financiare të përgjithshme, të kryer nga Komisioni.

<sup>42</sup> Dokumentacion i depozituar nga subjekti me *email*-in e datës 26.4.2023, si dhe fizikisht në datën 28.4.2023. Dokumentacioni paraqitet i njësuar me origjinalin nga noteri me nr. \*\*\*, datë 28.4.2023.

<sup>43</sup> Dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2023.

<sup>44</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.7.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**Tabela e përgjithshme e analizës financiare për periudhën 2014 – 2016**

<b>Përshkrimi</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>Pasuri</b>	<b>13 953</b>	<b>-127 284</b>	<b>347 553</b>
Autoveturë blerë më 2.8.2016			304 000
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	<i>13 953</i>	<i>(127 284)</i>	<i>43 553</i>
Likuiditete gjendje	14 759	(112 525)	(68 972)
<b>Detyrime</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>59 930</b>
Kredi konsumatore RBAL 23.9.2016			59 930
<b>Pasuri neto</b>	<b>13 953</b>	<b>(127 284)</b>	<b>287 623</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>683 063</b>	<b>1 495 073</b>	<b>1 603 140</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	641 336	996 956	1 025 255
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	41 727	498 117	577 885
<b>Shpenzime</b>	<b>494 137</b>	<b>741 248</b>	<b>808 217</b>
Shpenzime jetese	311 664	448 552	470 184
Shpenzime udhëtimi TIMS	92 473	64 696	5 000
Shpenzime mobilimi			56 930
Shpenzime qiraje	90 000	228 000	260 000
Shpenzime kredie-këstet			16 103
<b>Rezultati financiar</b>	<b>174 973</b>	<b>881 109</b>	<b>507 300</b>

39. Nga analiza financiare e përgjithshme për periudhën 2014 – 2016, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të krijojnë pasuri dhe të përballojnë shpenzimet me burime të ligjshme.

#### **40. Vlerësimi përfundimtar i kriterit të pasurisë**

41.1 Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ka kryer deklarime të sakta në deklaratën *Vetting* dhe ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e rivlerësimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë qenë në ndonjë rast në situatë konflikti interesi.

#### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

41. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.



42. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, AKSIK-ja ka dërguar një raport<sup>45</sup> në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar:

✓ Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të znj. Matilda S. Fetau.

#### **Vlerësimi i Komisionit për kontrollin e figurës**

43. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të kryer rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

44. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

#### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

45. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit<sup>46</sup> të hartuar nga KLGJ-ja për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
- denoncimeve të paraqitura sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

46. Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera, që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

##### **a. Gjetjet nga formulari i vetëdeklarimit**

47. Formulari paraqitet i plotësuar sipas shtojcës së ligjit. Të gjitha rubrikat janë plotësuar me saktësi, me shkrim të qartë e të lexueshëm. Formulari është nënshkruar rregullisht në çdo faqe.

##### **ii. Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ-së**

48. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Matilda Fetau ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, duke marrë titullin “Jurist”, Diplomë e Integruar

---

<sup>45</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, i deklasifikuar pjesërisht, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.4.2023, të KDZH-së.

<sup>46</sup> Raporti nr.\*\*\* prot., datë 15.9.2021, i KLGJ-së.

e Nivelit të Dytë nga Universiteti i Tiranës, në datën 13.7.2009, dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2015.

48.1 Me dekretin nr. 8768, datë 31.10.2014, të Presidentit të Republikës, znj. Matilda Fetau është caktuar për të kryer stazhin profesional pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me dekretin nr. 9653, datë 23.6.2016, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, ku vazhdon të ushtrojë edhe aktualisht detyrën.

48.2 Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, për gjyqtaren Matilda Fetau nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Matilda Fetau, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-KLD-ja.

### **iii. Përshkrimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short**

49. Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau, gjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka ushtruar funksionin e gjyqtares në dy gjykata të ndryshme, ku në periudhën tetor 2014 – gusht 2015 ka kryer stazhin profesional si kandidate për magjistrate në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërsa nga data 23.6.2016 e në vazhdim ushtron detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

#### **Konstatime të Komisionit**

50. Nga analizimi i dosjeve të vëzhguara, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional, por vetëm në dy raste (dosja 1 dhe 3) u evidentuan vonesa 1-ditore në zbardhjen e vendimeve gjyqësore.

#### **ANALIZA E GJETJEVE**

51. Nga analizimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short, sipas kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë rezultuar si vijon:

#### **52. Aftësitë profesionale**

52.1 Subjekti i rivlerësimit, gjyqtare Matilda Fetau, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Subjekti kualifikon drejt marrëdhënien juridiko-civile objekt shqyrtimi gjyqësor dhe zgjidh saktësisht në themel mosmarrëveshjet objekt gjykimi. Vendimet civile të dhëna prej saj ose nuk ankimohen nga palët, ose ankimohen dhe lihen në fuqi nga gjykatat më të larta.

52.2 Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme. Qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar,

provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse, u jepet përgjigje ligjore pretendimeve apo prapësimeve/kundërshtimeve të palëve të parashtruara gjatë gjyqimit, duke treguar se gjyqtarja ka qenë e vëmendshme ndaj kërkesave të tyre. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### **53. Aftësitë organizative**

53.1 Gjatë kohës së stazhit profesional të kryer në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në periudhën 31.10.2014 – gusht 2015, sipas të dhënave statistikore të vëna në dispozicion për efekt të shortit, gjyqtarja Matilda Fetau ka përfunduar së gjykuari 157 çështje penale e civile. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau është efiçente dhe efektive në çështjet që ajo ka shqyrtuar. Respektimi i kohës në gjykim përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor.

53.2 Subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka shfaqur aftësitë e duhura për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara. Konstatohet se asnjë seancë nuk ka dështuar për mangësi në organizimin e punës nga ana e gjyqtares. Seancat e vëzhguara përgjithësisht janë çelur sipas planifikimit, duke respektuar orarin e fillimit të tyre. Seancat gjyqësore nuk janë mbajtur me regjistrim audio. Nuk disponohen të dhëna për mundësitë që ka pasur gjyqtarja për t'i zhvilluar seancat me regjistrim audio.

53.3 Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi te gjyqtarja Matilda Fetau në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore.

### **54. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

54.1 Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares Matilda Fetau. Në Inspektoratin e ish-KLD-së, nuk rezultoi të ishte regjistruar asnjë ankesë për shkelje etike për gjyqtaren Matilda Fetau. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

54.2 Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau, por edhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Në Inspektoratin e ish-KLD-së nuk rezultoi të jenë regjistruar ankesa, ku të vihet në dyshim integriteti i gjyqtares Matilda Fetau.

54.3 Nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Matilda Fetau, nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve dhe nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me standardin e gjykatës së paanshme.

## **55. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

55.1 Nisur nga procesverbalet gjyqësore është konstatuar se gjyqtarja Matilda Fetau komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

55.2 Nuk janë evidentuar vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo vonesa të dukshme në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

55.3 Subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, të cilat i kanë shërbyer për të plotësuar më së miri formimin e saj profesional dhe etik. Krahas frekuentimit të seminareve të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës, ka ndjekur dhe ka marrë pjesë edhe në trajnime të organizuara nga institucione të tjera, vendëse apo të huaja.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

56. Komisioni, pas rivlerësimit të raportit të kryer nga KLGJ-ja, nuk gjeti *indicie* apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale.

## **DENONCIME**

57. Për subjektin e rivlerësimit Matilda Fetau janë depozituar 9 denoncime, ku një prej tyre është i përsëritur. Pra, në total janë 8 denoncime, të cilat janë analizuar nga Komisioni dhe ka rezultuar se 3 prej denoncimeve nuk plotësonin kërkesat e nenit 52/3 të ligjit nr. 84/2016 dhe në 3 denoncime të tjera nuk u konstatuan pretendime apo shkelje konkrete, që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me 2 denoncime, konkretisht:

### **58. Denoncim i shtetasit A.E<sup>47</sup>**

58.1 Ky shtetas ka paraqitur pranë Komisionit një ankim dhe një kallëzim penal drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ndaj gjyqtarës Matilda Fetau, si vijon:

58.2 Në datën 24.2.2020, denoncuesi ka paraqitur një kallëzim penal drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar ndaj subjektit të rivlerësimit Matilda Fetau, si dhe noterit I.H në Sh, për veprat penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, të parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal; “korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal; “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal; “falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal; “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal; “ndërhyrje në të dhënat

---

<sup>47</sup> Denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2022.

kompjuterike”, parashikuar nga neni 293/b i Kodit Penal; “forma të veçanta të bashkëpunimit”, parashikuar nga pika 4 e nenit 28 të Kodit Penal.

Në këtë kallëzim, denoncuesi përmend disa procedime penale - nr. \*\*/2018, \*\*/2018, \*\*/2019 dhe \*\*/2019 – në lidhje me vjedhjen e një hidrocentrali vendor në Xh, Librazhd, si dhe një çështje gjyqësore civile të regjistruar me nr. \*\*\* akti pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e shqyrtuar nga gjyqtarja Matilda Fetau, me paditës M.E e trashëgimtarë të tjerë dhe të paditur L.H, A.E, shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., Dh.Q notare, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Enti Regullator i Energjisë, QKB-ja, me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës për shitjen e kuotave të kapitalit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Denoncuesi pretendon se gjyqtarja Matilda Fetau nuk ka pranuar kërkesat e tij për ekzaminim dhe deklaram të disa akteve të falsifikuara, edhe pse këto dokumente sipas tij ishin deklaruar të falsifikuara më parë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Sipas denoncuesit, këto prova nuk u vlerësuan si të falsifikuara nga ana e gjyqtarës dhe as nuk pranoi të ekzaminohen.

Denoncuesi pretendon se dhënia e vendimit nga gjyqtarja Matilda Fetau është kryer mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara dhe me dyshimin e arsyeshëm se ky vendim është dhënë kundrejt shpërblimit dhe korrupsionit.

Komisioni ka kërkuar informacion pranë SPAK-ut, e cila ka informuar se emri i shtetas Matilda Fetau nuk rezulton të jetë i regjistruar në lidhje me këtë procedim penal.

58.3 Pretendimi i denoncuesit për dhënien e një vendimi të padrejtë nga ana e gjyqtarës Matilda Fetau, pasi vendimi i saj është bazuar në dokumente të falsifikuara, lidhet me themelin e çështjes dhe nuk është objekt shqyrtimi nga ana e Komisionit, pasi shqyrtohet nga gjykatat më të larta.

**58.4 Në lidhje me ankimin e paraqitur pranë Komisionit**, ky shtetas ankohet ndaj 3 gjyqtareve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, midis të cilave është edhe subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau, me pretendimin për afera korruptive.

Në këtë ankim, ndër të tjera, denoncuesi ka kërkuar që të verifikohet çështja penale me të pandehur E.D, akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, kryer në bashkëpunim sipas nenit 283/2 të Kodit Penal, për të cilën pretendon se tre gjyqtaret Matilda Fetau, Z.V dhe P.F kanë marrë nga 10 mijë euro/secila, për të aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, që të pezullonin vuajtjen e dënimit.

Denoncuesi pretendon se për këtë çështje gjyqësore gjyqtaret kanë caktuar seancë gjyqësore çdo javë, edhe pse për shkak të ngarkesës së madhe në gjykatë çdo çështje shtyhet më shumë se 1 muaj, ndërsa në këtë rast për 1 muaj është përfunduar në tërësi shqyrtimi i saj.

Sipas denoncuesit, tre gjyqtaret, ku subjekti është pjesë e këtij paneli, kanë favorizuar të pandehurin kryesor E.D, duke aplikuar nenin 59 të Kodit Penal, që është pezullimi i vuajtjes së dënimit, ndërsa për të pandehurin dytësor është vendosur vuajtja e dënimit me burgim.

58.5 Lidhur me këtë pretendim të denoncuesit, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumentacion për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

58.6 Subjekti i rivlerësimit, përmes prapësimeve të paraqitura në datën 25.5.2023, ka dhënë shpjegimet e saj në lidhje me pretendimet e denoncuesit për korrupsion, duke vlerësuar se gjatë punës së saj si gjyqtare ka zbatuar vetëm ligjin, duke e gjykuar këtë çështje penale me pavarësi dhe paanësi. Denoncimin për korrupsion subjekti e konsideron: *“Shpifje dashakeqëse dhe tentativa të dëshpëruara për të ulur integritetin e saj si gjyqtare dhe si njeri, me gjithë vështirësitë që kam hasur në këtë rrugëtim sfidues”*.

58.7 Në lidhje me pretendimin e denoncuesit, se në çështjen gjyqësore penale me të pandehur shtetasin E.D ka aplikuar nenin 59 të Kodit Penal (pezullim të vuajtjes së dënimit), ndryshe nga i pandehuri tjetër, S.B, subjekti ka prapësuar se:

Me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.2.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me trup gjykues të kryesuar prej saj, ka vendosur, ndër të tjera, dënimin e të pandehurit E.Z(D) me 7 vjet e 6 muaj burgim, në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale. Për shkak të gjykimit të shkurtuar, është ulur 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 5 vjet burgim dhe, në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, për pjesën e pavuajtur të dënimit, gjykata ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim, për një periudhë prej 5 vjetësh, me kusht që i pandehuri gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale.

58.8 Subjekti ka shpjeguar se për të pandehurin E.Z(D) ka zbatuar me përpikëri kërkesat e nenit 59 të Kodit Penal për “pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë”, duke u bazuar në provat e administruara në dosjen gjyqësore dhe, nga interpretimi i këtij neni, rezulton se i jep të drejtën gjykatës që, në raste të veçanta, kur jep dënimin me burgim deri në pesë vjet, të urdhërojë që i dënuari të vihet në provë, duke u pezulluar ekzekutimi i dënimit.

58.9 Subjekti ka argumentuar se gjykata kur vendos për aplikimin e këtij dënimi alternativ, është e detyruar të respektojë kriteret e përcaktuara në këtë nen, që aplikohet kur plotësohen njëkohësisht dy kushte: *së pari*, në përfundim të gjykimit, gjykata çmon se i pandehuri duhet të dënohet jo më shumë se 5 vjet me burgim; *së dyti*, kur gjatë shqyrtimit rezulton se ekziston një nga rrethanat e mëposhtme, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra, por nuk përjashtojnë njëra-tjetrën – kur i pandehuri paraqet rrezikshmëri të pakët shoqërore, është i mitur apo i moshuar, ka kushte mendore apo shëndetësore të veçanta, ka detyrime për punën, arsimin, kualifikimin apo aftësimin profesional, ka përgjegjësi thelbësore familjare, i pandehuri e ka kryer veprën në kushtet e disa rrethanave lehtësuese, si dhe ka pasur një sjellje shumë të mirë pas kryerjes së veprës penale.

58.10 Sipas subjektit, gjykata në aplikimin e kësaj alternative të dënimit me burgim duhet të mbajë parasysh edhe disa elemente të përgjithshme, të cilat vlerësohen edhe në rastin e caktimit të dënimit dhe që lidhen me tipare të moshës dhe personalitetit të të dënuarit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj, shkallën e

fajit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si elemente të përgjithshme që lidhen me rrethanat e kryerjes së veprës penale dhe sjelljen e autorit pas kryerjes së saj.

Për sa i përket ekzistencës së rrethanave të tjera të parashikuara nga neni 59 i Kodit Penal, subjekti ka evidentuar faktin se i pandehuri E.Z ka pasur përgjegjësi thelbësore familjare, për arsye se ishte i martuar dhe kishte në ngarkim të tij dy fëmijë, të moshës 9 dhe 6 vjeç dhe bashkëshorten e tij M.Z, e cila vuante nga çrregullime depresive post-traumatike në terren me anemi feriprive, duke qenë e paaftë për t'u kujdesur për fëmijët e saj të mitur. Kjo gjendje shëndetësore psiko-patologjike e bashkëshortes së të pandehurit provohej nga kartela ditore e datës 25.9.2021 e qendrës spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, si dhe nga vlerësimi psikologjik i datës 12.7.2021, i administruar në dosjen gjyqësore.

Për sa më sipër, subjekti ka shpjeguar se gjykata ka çmuar se i pandehuri E.Z ka përgjegjësi thelbësore familjare, për shkak se ka dy fëmijë të mitur dhe bashkëshortja e tij ishte e paaftë të kujdesej e vetme për fëmijët e saj.

Përveç sa më sipër, sipas subjektit, i pandehuri paraqiste rrezikshmëri të pakët shoqërore, nisur nga fakti se ishte i padënuar më parë dhe që në momentin e parë e ka pranuar veprën penale, ndonëse jo të kryer në bashkëpunim, dhe ka treguar pendim të thellë, duke kërkuar mëshirë nga gjykata. Në lidhje me aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal në çështjen penale objekt gjykimi, subjekti ka shpjeguar se u është referuar disa vendimeve<sup>48</sup> të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

58.11 Në vlerësimin e rrethanave të sipërcituara, subjekti ka vlerësuar se në rastin konkret ekzistojnë kushtet ligjore dhe faktike, që ndaj të pandehurit E.Z të aplikohet alternativa e “pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë”, duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë prove prej 5 vjetësh, me kusht që gjatë kohës së provës të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mos shoqërohet me persona të dënuar, kryesisht për këtë veprë penale. Sipas subjektit, në rastin e të pandehurit S.B, nuk kishte ndonjë rrethanë të tillë nga ato që parashikon neni 59 i Kodit Penal, që ndaj tij të aplikohet kjo alternativë e dënimit me burgim. Fakti që i pandehuri është i padënuar, ishte element i pamjaftueshëm për të aplikuar ndaj tij alternativën e dënimit me burgim të parashikuar nga neni 59 i Kodit Penal.

58.12 Subjekti ka theksuar faktin se ky vendim gjyqësor është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.9.2022, i cili e ka konsideruar të drejtë vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal për të pandehurin E.Z dhe për mosaplikimin e nenit 59 për të pandehurin S.B. Në lidhje me seancat gjyqësore, subjekti ka prapësuar se ato janë caktuar në përputhje me nenin 342 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka depozituar kopje të dosjes gjyqësore përkatëse.

## **Vlerësimi i Komisionit**

---

<sup>48</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 6.11.2013, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; vendim nr. \*\*, datë 20.5.2015, i Gjykatës së Lartë; Vendim nr. \*\*, datë 4.5.2016, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; vendim nr. \*\*, datë 26.1.2012, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

58.13 Komisioni vlerëson se subjekti përmes shpjegimeve të saj dhe akteve të dosjes gjyqësore të depozituar në prapësime arriti të provojë bindshëm arsyet dhe shkaqet ligjore të aplikimit të këtij dënimi alternativ. Në referim të parashikimeve të nenit 59 të Kodit Penal, ku përcaktohen qartë kushtet dhe rrethanat për zbatimin e kësaj dispozite, Komisioni e çmon të drejtë qëndrimin e subjektit të rivlerësimit lidhur me pezullimin e ekzekutimit të dënimit ndaj të pandehurit E.D.

58.14 Nga verifikimi i kryer lidhur me këtë çështje nuk u evidentua ndonjë shkelje ligjore e kryer nga subjekti i rivlerësimit apo që të ketë kryer ndonjë veprim që cenon figurën e magjistratit apo aftësitë e saj profesionale.

## **59. Denoncim<sup>49</sup> i shtetasit B.D**

59.1 Ky shtetas ankohet për shkelje të rënda procedurale dhe ligjore të kryera nga ana e gjyqtarës Matilda Fetau, lidhur me një çështje gjyqësore penale të vitit 2022, në ngarkim të tij, i akuzuar për veprën penale “deklarim i rremë para oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal.

59.2 Denoncuesi ankohet se pas shpalljes së vendimit në datën 20.1.2022, 6 muaj më vonë i janë komunikuar dy dëftesa komunikimi, për dy vendime gjyqësore me të njëjtin numër dhe datë, me dy përmbajtje të ndryshme, ku në njërin prej vendimeve është vendosur kthimi i akteve prokurorisë për veprën penale “mashttrim”, ndërsa në vendimin tjetër është vendosur pushimi i pjesshëm i çështjes penale për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.

59.3 Denoncuesi pretendon se në vendimin e parë, referuar nenit 332/d, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, gjykata duhej të lejonte organin procedues për komunikimin e akuzës së re kur edhe i pandehuri jep pëlqimin dhe këtë fakt nuk e gjen të pasqyruar në vendim, por konstaton vetëm kthimin e akteve për shkak të akuzës së re dhe përsëri vendimi i gjyqtarës u njoftohet palëve 6 muaj me vonesë, duke shkelur afatet procedurale të zbardhjes së vendimeve dhe njëkohësisht respektimin e afatit të kryerjes së hetimeve. Sipas denoncuesit, kjo vonesë nuk e justifikon ligjërisht kryerjen e hetimeve për akuzën e re, pasi emri i të pandehurit është regjistruar në regjistrin e veprave penale dhe vendimi i gjykatës duhej të ishte zbardhur brenda afatit ligjor, me qëllim përfundimin e hetimeve në afatin e caktuar në vendim brenda 2 muajve.

59.4 Denoncuesi pretendon se gjykata nuk mund të çmojë njëherazi, sipas nenit 329, paragrafi 3, shkronja “b” e Kodit të Procedurës Penale, duke urdhëruar kthimin e akteve dhe vazhdimin e hetimeve, pasi hetimet janë të paplota dhe, sipas nenit 329, paragrafi 3, shkronja “c” e Kodit të Procedurës Penale, për kthimin e akteve duke formuluar akuzë të re dhe paraqitur kërkesë për gjykimin e çështjes, pasi çmon se hetimet janë të plota.

59.5 Këto vendime janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, ku sipas denoncuesit kryesuesja e seancës ka konstatuar se në dosjen gjyqësore ndodhej vetëm njëri prej vendimeve. Për rrjedhojë, i ka kërkuar me shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan vendimin tjetër gjyqësor, i cili, pasi është dërguar nga kjo gjykatë, ka rezultuar se vendimi i pushimit të veprës penale “shkaktim i vetëvrasjes” kishte marrë formë të

---

<sup>49</sup> Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2022.



prerë, ndonëse në Gjykatën e Apelit Durrës ndodhej kërkesa ankimore e paraqitur në afat ndaj këtij vendimi.

59.6 Në lidhje me këto pretendime të denoncuesit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

59.7 Në lidhje me pretendimet e denoncuesit, subjekti me prapësimet e datës 25.5.2023 ka shpjeguar se nga ana e saj si gjyqtare nuk është kryer asnjë shkelje ligjore apo procedurale ligjore, pasi ka gjykuar këtë çështje me paanësi, pavarësi dhe profesionalizëm në përputhje me nenet 332 dhe 332/ç të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në përputhje me nenin 329/3/b të këtij Kodi.

59.8 Subjekti ka parashtruar rrethanat e çështjes gjyqësore penale, ku denoncuesi B.D ishte marrë i pandehur nga organi i prokurorisë vetëm për veprën penale “deklarim i rremë përpara oficerit të policisë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal dhe nuk kishte ngritur akuzën “mashttrim me pasoja të rënda”, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

59.9 Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, gjykata ka konstatuar se provohej se i pandehuri B.D kishte kryer edhe veprën penale “mashttrim” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe, për rrjedhojë, ka urdhëruar organin e akuzës që ndaj të pandehurit të ngrihej edhe kjo akuzë. Megjithatë, për ta plotësuar provueshmërinë e akuzës në ngarkim të të pandehurit B.D dhe nisur nga pretendimet e trashëgimtarëve të viktimës A.S, se ai ishte mashtruar edhe nga persona të tjerë, subjekti ka urdhëruar prokurorinë që të kryejë disa veprime hetimore të përcaktuara në vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 26.1.2022, me qëllim që hetimi të ishte shterues dhe i plotë.

59.10 Kështu, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, gjyqtarja Matilda Fetau ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që i përkasin procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2020, për të vazhduar hetimet, duke formuluar edhe akuzën për veprën penale “mashttrim” me pasoja të rënda, për të pandehurin B.D, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal, të cilat duhet të përfundonin brenda 2 muajve nga dita e komunikimit të këtij vendimi.

Gjithashtu, në këtë vendim, subjekti ka vendosur pushimin e pjesshëm të çështjes penale për procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2020, për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal.

59.11 Lidhur me pretendimin e denoncuesit se vendimi gjyqësor i është komunikuar 6 muaj me vonesë, subjekti ka prapësuar se ky vendim është shpallur në sallë dhe avokatja e të pandehurit ka qenë e pranishme. Sipas shpjegimeve të subjektit, në dosjen gjyqësore, krahas kërkesës për dërgimin në gjyq, prokuroria kishte kërkuar në gjykatë me kërkesë të posaçme edhe pushimin e pjesshëm të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2020, për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, të parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal dhe për këtë kërkesë gjykata ka disponuar me vendim, duke pranuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e pjesshëm të procedimit penal.

59.12 Subjekti ka prapësuar se të pandehurit B.D nuk i është cenuar asnjë e drejtë, përderisa i janë komunikuar të dyja vendimet, me dy dëftesa komunikimi të ndryshme

dhe procedura e njoftimit të vendimeve ndiqet nga kryesekretaria e gjykatës, e cila verifikon dëftesat e komunikimit dhe ankimet e më pas kryen veprime për përcjelljen e dosjes në Gjykatën e Apelit. Subjekti ka shpjeguar se gjyqtari që ka gjykuar çështjen, pas dorëzimit të dosjes në kryesekretari, nuk kryen asnjë veprim administrativ, pasi me ligj i është ngarkuar kryesekretarisë së gjykatës.

Kështu, në dosjen origjinale të prokurorisë, është qepur vendimi për kthimin e akteve prokurorisë dhe në kopjen e njëzuar me origjinalin të po së njëjtës dosje është qepur vendimi për pushimin e pjesshëm të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit.

Sipas subjektit, gabimisht kryesekretaria nuk kishte dërguar në Gjykatën e Apelit Durrës fashikullin e pushimit të pjesshëm të çështjes penale për të pandehurin B. D. Pas ardhjes së kërkesës nga Gjykata e Apelit Durrës, në cilësinë e zëvendëskryetares, ka verifikuar veprimet e kryesekretarisë dhe ka konstatuar që fashikulli i pushimit të pjesshëm të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit B.D nuk ishte dërguar në Gjykatën e Apelit. Menjëherë kanë dërguar këtë fashikull, së bashku me vendimin e pushimit të çështjes penale në Apel.

59.13 Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin \*\*\*, datë 5.12.2022, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 26.1.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Elbasan, në lidhje me pushimin e pjesshëm të çështjes penale për veprën penale “shkaktim i vetëvrasjes”, parashikuar nga neni 99 i Kodit Penal dhe ndryshimin e vendimit në lidhje me kthimin e akteve prokurorisë për të vazhduar hetimet dhe për të formuluar edhe akuzën “mashttrim” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal në këtë mënyrë: *“Kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Elbasan, duke urdhëruar që të formulojë për të pandehurin B.D edhe akuzën për veprën penale “mashttrim” me pasoja të rënda, parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal dhe të paraqesë kërkesë për gjykim të çështjes penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/3 dhe 305/b të Kodit Penal, duke i konsideruar të plota hetimet në këtë drejtim”*.

59.14 Subjekti ka argumentuar se referuar arsytimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, gjyqtarja ka vendosur drejt në lidhje me pushimin e pjesshëm të akuzës, por edhe urdhërimin e organit të prokurorisë që të ngrëjë akuzën “mashttrim” me pasoja të rënda, të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal. Kjo do të thotë se Gjykata e Apelit Durrës nuk ka ndryshuar pjesën esenciale të vendimit të gjyqtares, pasi e ka gjetur të drejtë vendimin e saj se i pandehuri B.D duhet të merrej i pandehur edhe për veprën penale “mashttrim”.

Subjekti ka shpjeguar se Gjykata e Apelit Durrës ka ndryshuar vetëm pjesën e vendimit, ku urdhërohet kryerja e disa veprimeve hetimore shtesë, por pjesa thelbësore e vendimit nuk është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Durrës. Subjekti vlerëson se ka treguar profesionalizëm në këtë vendim gjyqësor ndaj të pandehurit B.D dhe Gjykata e Apelit Durrës nuk ka gjetur asnjë shkelje procedurale në gjykimin e kësaj çështjeje penale në ngarkim të të pandehurit B.D. Subjekti ka shpjeguar se kjo dosje penale ndodhet në Gjykatën e Apelit Durrës dhe nuk ka ardhur në Gjykatën e Rrethit Gjiqësor Elbasan, por në gjykatë kishte ardhur vetëm vendimi i dhënë nga Gjykata e Apelit Durrës për këtë çështje penale. Subjekti ka dërguar vendimet gjyqësore të sipërcituara.

## **Vlerësimi i Komisionit**

59.15 Komisioni vlerësoi shpjegimet e dhëna nga subjekti në prapësime, duke i konsideruar ato bindëse, nisur edhe nga fakti se vendimet gjyqësore janë verifikuar dhe shqyrtuar edhe nga Gjykata e Apelit Durrës, e cila nuk ka konstatuar shkelje procedurale në gjykimin e çështjes nga ana e subjektit të rivlerësimit.

## **Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale**

Nga hetimi i thellë administrativ i kryer, nuk u provua asnjë *indicie* apo element që cenon figurën e gjyqtarës Matilda Fetau dhe, sipas parashikimeve të nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, është efiçente dhe efektive në masë të pranueshme dhe, përfundimisht, u vlerësua për kriterin profesional “e aftë”.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoji subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Matilda Fetau ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Matilda Fetau, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

2. Ky vendim, i arsytuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
  4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, më 29.5.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Roland ILIA**  
**Kryesues**

**Suela ZHEGU**  
**Relatore**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Etmonda Hoxha*